



Lista përjashtuese

Asnjë marrëdhënie afariste nuk duhet të krijohet apo ruhet me klientët e përfshirë në ndonjë nga veprimtaritë në vijim:

Kushtet joetike dhe të punës:

- a) Prodhimi apo veprimtaria që përfshijnë forma të dëmshme apo abuzuese të punës së detyrueshme/punës së dëmshme për fëmijë¹, praktika diskriminuese, apo praktika të cilat i parandalojnë punonjësit nga ushtrimi i ligjshëm i të drejtave të tyre të asociimit dhe të marrëveshjes kolektive
- b) Prodhimi apo tregtia e narkotikëve²
- c) Prodhimi apo tregtia me armë (përfshirë armët për gjueti) dhe municion³
- d) Lojërat e fatit (përfshirë lojërat online të fatit), kazinotë dhe ndërmarrjet ekuivalente⁴
- e) Lëshimi apo operimi me platforma të këmbimit të krypto valutave
- f) Prostitucioni dhe çdo biznes për të cilin afarizmi primar lidhet me pornografi

Aktivitetet e dëmshme për shëndetin, sigurinë dhe mjedisin:

- g) Prodhimi apo tregtia me apo shfrytëzim të fibrave të shturura të azbestit apo produkte me përbërje të azbestit⁵;
- h) Prodhimi apo tregtia me prodhimet që përmbajnë bifenile poliklorure⁶;
- i) Prodhimi ose tregtia me barna, pesticide/herbicide dhe substanca të tjera të rrezikshme që i nënshtrohen ndalesave ose daljes nga përdorimi me rregullat ndërkombëtare⁷;
- j) Prodhimi apo tregtia me materiale radioaktive (përfshirë deponimin dhe trajtimin e mbeturinave radioaktive), biznes apo aktivitete lidhur me industrinë nukleare apo materialet nukleare⁸;
- k) Peshkimi me rrjeta në ambient detar duke përdorur rrjeta që kanë gjatësi më të madhe se 2.5 km;
- l) Transporti i naftës ose substancave të tjera të rrezikshme në anije-cisterna që nuk i respektojnë kërkesat e Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO)⁹;
- m) Aktiviteti që lidhet me lëshimin e organizmave të modifikuar gjenetiki në ambientin natyror pa aprovim nga autoritetet kompetente ose kur autoriteti relevant është deklaruar vetë se nuk lejon organizma të modifikuar gjenetiki¹⁰
- n) Aktivitetet brenda zonave të mbrojtura me ligj të përcaktuara nën kategorinë IUCN I-IV;¹¹
- o) Tregtia me kafshë të egra dhe produkte të kafshëve të egra e rregulluar sipas CITES¹²;
- p) Lëvizjet ndër-kufitare të mbeturinave që janë të ndaluara me ligjin ndërkombëtar¹³;
- q) Ndërtimin e kaskadave ujore pa vlerësimin e duhur mjedisor;
- r) Prodhimi ose tregtia me substanca që e harxhojnë ozonin e që janë në listën e ODS të protokollit të Montrealit¹⁴;
- s) Veprimtaria e prerjes së drunjëve për qëllime komerciale ose blerja e pajisjeve për prerjen e drunjëve në pyjet tropikale dhe tregtia me drunjë ose produkte të tjera pyjore që nuk janë nga pyjet e menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme për ambientin¹⁵;
- t) Shfrytëzimi i minierave të diamantit dhe komercializimi i diamanteve, kur shteti i eksplotimit nuk e ka respektuar marrëveshjen Kimberley (KPCS) ose marrëveshjet e tjera të ngjashme ndërkombëtare për resurset e nxjerra nga toka.
- u) Gërmimet nëntokësore në miniera për të nxjerrë minerale, qymyr, rreshpe naftë dhe minerale të tjera.
- v) Prodhimi

Ndikimi negativ në komunitet:

- w) Prodhimi apo tregtia e ndonjë produkti apo aktiviteti që konsiderohet ilegal në vendin nikoqir (d.m.th. kombëtar) ligjet apo rregulloret apo konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare dhe, përfshirë pa kufizim, legjislacionin apo konventat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e burimeve¹⁶ të biodiversitetit apo trashëgiminë kulturore;
- x) Aktivitetet në tokën e zënë nga popujt indigjenë ose grupet e ndjeshme, ose afër tokës së tillë, siç janë tokat dhe rrjedhat e ujërave që përdoren për aktivitete të jetës si kullosat e bagëtive, gjuetia ose peshkimi;
- y) Aktivitetet që mund të kenë ndikim negativ në vendet me rëndësi kulturore ose arkeologjike;
- z) Aktivitetet që lidhen me zhvendosjen e pavullnetshme të njerëzve;

Klientët e angazhuar në ndonjë nga aktivitetet e mëposhtme nuk duhet të financohen:

- Prodhimin ose tregtinë e pijeve alkoolike (duke mos përfshirë birrën dhe verën)¹⁷
- Prodhimin në masë ose tregtinë e duhanit¹⁸



- 1 Kjo përfshin çdo aktivitet të lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore. "Puna e detyruar" do të thotë puna ose shërbimet që nuk kryhen vullnetarisht, kur individit detyrohet duke e kërcënuar me forcë ose me dënim. Puna e dëmshme e fëmijëve do të thotë punësimi i fëmijëve duke i shfrytëzuar ekonomikisht, ose që mund të jetë i rrezikshëm për fëmijët, ose të ndërhyjë në arsimimin e fëmijës, ose të jetë i dëmshëm për shëndetin e fëmijës, ose për zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral ose social. Për më shumë informata referojuni: IFC (shih IFC/MIGA deklarata e përbashkët e politikave për punën e detyruar dhe punën e dëmshme të fëmijëve); deklarata e ILO për parimet fundamentale dhe të drejtat në punë, dhe parimet e mishëruara në këto konventa: konventat e ILO 29 dhe 105 (puna e detyruar), 87 (liria e shoqërimit), 98 (e drejta për marrëveshje kolektive), 100 dhe 111 (diskriminimi); 138 (mosha minimale); 182 (format më të këqija të punës së fëmijëve); deklarata universale e të drejtave të njeriut.
- 2 Shprehja "narkotikë" i referohet të gjitha drogave ilegale narkotike natyrale dhe sintetike dhe substancave psikotropike. Për referencë të mëtejme, ju lutemi referojuni Konventës së Vetme të OKB-ës për Drogat Narkotike (1961) si dhe Listës së Verdhë të Bordit Ndërkombëtar të Kontrollit të Narkotikëve (INCB).
- 3 Kompanitë e sigurimit që blejnë armë të vogla dhe municionet e tyre për shfrytëzim të tyre dhe pa qëllim të rishitjes së tyre, nuk përfshihen në këtë dispozitë.
- 4 Kjo dispozitë nuk i përfshinë lotaritë bamirësie, të cilat i investojnë të ardhurat e tyre në veprimtari bamirësie për përfitim të gjerë si dhe të atyre personave ose subjekteve që krijojnë më pak se 25% të qarkullimit të tyre përmes ofrimit të lojërave të fatit.
- 5 Kjo nuk zbatohet për blerjen dhe shfrytëzimin e çimentos me azbest të lidhur ku përmbajtja e azbestit është <20%.
- 6 Bifenilet poliklorure: një grup i kemikalieve shumë toksike që ka të ngjarë të gjenden në transformatorët elektrikë me naftë, kondensatorët dhe ndërprerësit që datojnë nga vitet 1950-1985.
- 7 Një listë e produkteve që i nënshtrohen daljes nga përdorimi ose ndalesave është në dispozicion nga IFC ose EBRD. Dokumentet për referencë përfshijnë Rregulloren e BE-së (EEC) Nr. 2455/92 lidhur me eksportin dhe importin e disa materieve kimike të rrezikshme, e ndryshuar; listën e konsoliduar të OKB-së të produkteve konsumimi ose shitja e së cilave është ndaluar, tërhequr, kufizuar rreptë ose nuk është aprovuar nga qeveritë; Konventën për procedurat e pajtimit paraprak në bazë të informimit për disa kimikale të rrezikshme dhe pesticide në tregtinë ndërkombëtare (Konventa e Roterdamit); Konventa e Stokholmit për ndotësit organikë; Klasifikimin e OBSh të pesticideve sipas rrezikut.
- 8 Kjo nuk zbatohet për blerjen e pajisjeve mjekësore, pajisjeve të kontrollit të cilësisë (matjeve) dhe pajisjeve të tjera ku burimi radioaktiv është shumë i vogël dhe/ose i mbrojtur në mënyrën e duhur.
- 9 Këto përfshijnë: cisternat që nuk i kanë certifikatat e kërkuara të MARPOL SOLAS (duke përfshirë pa kufizime, pajtueshmërinë me kodin e ISM), cisternat në listën e zezë të Bashkimit Evropian ose që janë të ndaluara me Memorandumin e Parisit për kontrollin e limaneve shtetërore (Memorandum i Parisit), dhe cisternat që duhet të dalin nga përdorimi sipas rregulloreve 13G dhe 13H të Aneksit i të MARPOL. Asnjë cisternë e vjetër më shumë se 25 vite nuk bën të përdoret.
- 10 Për shtetet e BERZH-it: aktivitetet që përfshijnë lëshimin e organizmave të modifikuar gjenetikisht në mjedisin natyror duhet të referohen në BERZH dhe të krahasohen me kërkesat e zbatueshme të performancës.
- 11 Aktivitetet brenda çdo zone të mbrojtur siç janë të përmendura në mënyrë specifike duhet të vlerësohen rast për rast sipas përcaktimit të Standardeve të Grupit për Menaxhimin e Ndikimit Mjedisor dhe Social të Kreditimit. Zonat e tjera të mbrojtura mund të jenë p.sh. të klasifikuar nën kategorinë V dhe VI të IUCN, vendet e Trashëgimisë Natyrore të UNESCO-s, vendet e Ramsarit (Konventa mbi Ligatinat me Rëndësi Ndërkombëtare), Vendet Emerale (Konventa e Bernës), Natura 2000.
- 12 CITES: Konventa për tregti ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër. Lista e llojeve sipas CITES është në dispozicion nga IFC ose EBRD. Për të gjetur se cilat lloje gjenden në listë, vizitoni <http://www.cites.org> ose qasuni databazës së llojeve të CITES në <http://www.cites.org/eng/resources/species.html>
- 13 Dokumentet e referencës janë: Rregullorja e (KE) nr. 1013/2006 e datës 14 qershor 2006 për transportin e mbeturinave; vendimi C(2001)107/Final i këshillit të OECD lidhur me rishikimin e vendimit C(92)39/Final për kontrollin e lëvizjes ndërkufitare të mbeturinave që janë dedikuar për operacione të rikuperimit; Konventa e Bazelit e datës 22 mars 1989 për kontrollin e lëvizjes ndërkufitare të mbeturinave të rrezikshme dhe largimin e tyre. Për informata të mëtejshme dhe udhëzues të thjeshtësuar të Konventës së Bazelit vizitoni: <https://www.basel.int>
- 14 Substancat që e harxhojnë ozonin (SHO): bashkëdyzime kimike që reagojnë dhe harxhojnë ozonin në stratosferë, duke pasur si rezultat të ashtuquajturat 'vrimat e ozonit'. Protokollin e Montrealit i rendit në listë substancat që e harxhojnë ozonin dhe datat e synuara për zvogëlimin dhe heqjen e tyre nga përdorimi. Lista e bashkëdyzimeve kimike e rregulluar me Protokollin e Montrealit, që përfshin aerosolet, ftohësit, agjentët që krijojnë shkumë, tretësit, dhe agjentët për mbrojtje nga zjarri, bashkë me detajet e shteteve nënshkruese dhe datat e synuara kur duhet të dalin nga përdorimi, është në dispozicion nga IFC ose EBRD.
- 15 Pyjet e menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme duhet të certifikohen nga certifikues ndërkombëtarë dhe shtetëror (nëse ka), ose duhet të menaxhohen në përputhje me politikën e bankës për financimin e prerjes së pyjeve.
- 16 Konventat relevante ndërkombëtare të biodiversitetit përfshijnë pa kufizime: Konventën për konservimin e llojeve migruese të kafshëve të egra (Konventa e Bonit); Konventën për kënetat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitati Waterfowl (Konventa e Ramsarit); Konventa për konservimin e natyrës së egër në Evropë dhe habitateve natyrore (Konventa e Bernit); Konventa për trashëgiminë botërore; Konventa për diversitetin biologjik.
- 17 Kjo nuk aplikohet për klientët/ndërmarrjet që nuk janë të përfshira substancialisht në këto veprimtari. "Jo të përfshira substancialisht" do të thotë se aktiviteti në fjalë është mbështetës i aktiviteteve primare të klientit. Përjashtimet mund të bëhen me miratim të IFC-së.
- 18 Si më lartë.